

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

Skicim Skicimet, parametrat teknik etj:

- Shërbimi i Ruajtjeve dhe Sigurisë Fizike do të kryhet në Drejtorinë e Shëndetit Publik Gramsh, duke përfshirë Godinën dhe çdo gjë që ndodhet brenda këtij territori. Ruajtja kekohet të kryhet me 1 (një) vendroje me 2 roje, nga ora 20.00 deri 06.00, për çdo ditë (e hënë- e shtunë) dhe 24 orë për ditët e djela dhe ditët e festave zyrtare.

### **Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:**

- Numri i rojeve do të jetë 2 roje. Firma fituese është e detyruar të ruajë objektet e mesipërme me këto numër rojesh;
- Të mbulojë të gjitha shpenzimet si paga të rojeve, sigurimet shoqërore të personelit të punësuar nga ana e tij për ruajtjen e objekteve, shpenzimet për uniformat, armatime, nderlidhje si dhe gjithë kompensimet e tjera të njohura me ligj.
- Sigurimi i rendit dhe qetesise në objektet që ruan, duke parandaluar demtimin e pronës së punedhësit ose vjedhjen e saj.
- Të ushtrojë kontroll të herë pas herëshëm të personave që hyjnë në territorin e objekteve që ruhen si dhe automjeteve që qarkullojnë në territorin e saj.
- Të kërkojë zbatimin e rregullave të percaktuara nga punedhësi si dhe rregulloret të brendshme të nxjerra nga ky i fundit të cilat do të jenë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.
- Të informojë rregullisht titullarin e institucionit për shkelje të konstatuara.
- Sipërmarresi mban përgjegjësi për demtimet apo vjedhjet që mund të ndodhin në territorin e objektit që ruhet nga ana e tij kur këto vijnë si rezultat i mungesës së vigjilencës të rojeve dhe mosorganizimit të mirë të shërbimit. Në këto raste sipërmarresi detyrohet të bëjë cëmtimin e pasurisë së vjedhur apo demtuar në masën 100% të vlerës së demtuar.
- Demtimin e vlerave materiale gjatë shoqërimit prej tyre duke bërë cëmtimin 100% të vlerës së demtuar si dhe përgjegjësinë për jetën e personave që bëjnë shoqërimin e mjeteve monetare.
- Gjatë shërbimit punonjësi do të jetë me uniformën e caktuar dhe me kartën e identitetit personal për çdo punonjës.
- Vendroja do të jetë e pajisur me armatimin e domosdoshëm dhe me pajisjet ndihmëse që përcaktohen në ligjet dhe udhëzimet përkatëse.
- Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me mjete ndërlidhje për komunikim me SHRSF si dhe për parandalimin e ndalimin e veprimtarisë së keqbërësve në dem të objektit që ka nën ruajtje dhe nën përgjegjësinë personale të tij.
- Përveç specifikimeve të mësipërme, marrëdhëniet më të detajuara midis SHRSF dhe Drejtorisë së Shëndetit Publik Gramsh do të jepen në rregulloren e shërbimit që do të jetë pjesë përbërëse e kontratës.

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Sherbimi qe kerkohet:

- ❖ *Vendroja nr. 1 Godina e Drejtorise se Shendetit Publik ne Lagjen «Sporti», Ish Infektivi Gramsh.*
  
- ❖ *Sherbimi i Ruajtjese dhe Sigurise Fizike do te kryhet ne Drejtorine e Shendetit Publik Gramsh, duke perfshire Godinen dhe çdo gje qe ndodhet brenda ketij territori. Ruajtja kekohet te kryhet me 1 (nje) vendroje me 2 roje, nga ora 20.00 deri 06.00, per cdo dite (e hene- e shtune) dhe 24 ore per ditet e djela dhe ditet e festave zyrtare.*

Afatet e ekzekutimit: 10 muaj duke filluar nga (01.03.2017 deri 31.12.2017)

### TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

**Fitues i kontrates do ti kerkohet:**

1. Sherbimi privat i sigurise fizike te kryhet ne zbatim ne Ligjit 75/2014, 74/2014, Udhezimit te MB nr.157, date 01.04.2015 "Per funksionimin e Shpsf" si dhe akteve nenligjore ne zbatim te tyre.
2. Sherbimi i Ruajtjese dhe Sigurise Fizike do te kryhet ne Drejtorine e Shendetit Publik Gramsh, duke perfshire Godinen dhe çdo gje qe ndodhet brenda ketij territori. Ruajtja kekohet te kryhet me 1 (nje) vendroje me 2 roje, nga ora 20.00 deri 06.00, per cdo dite (e hene- e shtune) dhe 24 ore per ditet e djela dhe ditet e festave zyrtare. Punonjesit e sherbimit te jene te çertifikuar konforme Ligjit 75/2014, si dhe te kene kontrata pune te lidhura te vlefshme.
3. Punonjesi i sherbimit ne detyre te jete i pajisur me uniformen, shenjen dalluese, emblemen, stemen e shoqerise, dokumentin identifikues si dhe pajimet personale si rrip multifunksional, shkop gome, hekura lidhes konforme ligjit 75/2014 dhe Udhezimit te MB nr.157, date 01.04.2015 "Per funksionimin e Shpsf".
4. Te vere ne dispozicion per sigurimin e objektit qendren e kontrollit, te pajisur me sistem nderlidhje, radiokomunikimi dhe te ofroje sherbim/monitorimi 24 ore per menaxhimin e sherbimit. Te siguroje nje grup te gatshem i pajisur me uniforme, armatim, nderlidhje, automjet me logon e shoqerise si dhe pajisje te tjera speciale per nderhyrje ne rast emergjence.
5. Vendsherbimi te jete i pajisur me: - nje arme brezi dhe me lejet e perdorimit ne vendsherbim , nje radio-komunikimi dore dhe nje bodygard spray, te cilet perdoren nga cdo punonjes sherbimi sipas turnit perkates.

6. Te mbuloje te gjitha shpenzimet si detyrimet fiskale, paga e rojeve , sigurimet shoqerore te personelit te punesuar nga ana e tij per ruajtjen e objekteve , shpenzimet per uniformat, armatime, nderlidhje si dhe gjithë kompesimet e tjera te njohura me ligj.
7. Kontraktori mban pergjegjesi per demtimet apo vjedhjet qe mund te ndodhin ne territorin e objektit qe ruhet nga ana e tij, kur keto vijne si rezultat i moskryerjes me korektesi te sherbimit apo mungeses se vigjilences te rojeve, dhe qe vertetohet nga organet kompetente.Ne kete rast kontraktori detyrohet te beje çdemtimin 100% te vleres se demtuar.

### **Detyrat:**

- Te mos lejoje futjen e personave ne objekt pa autorizim nga titullari.
- Te mos lejoje hyrjen dhe daljen e materialeve pa autorizimin perkates.
- Per persona qe vijne per probleme pune, duhet te njoftoj me pare kerkuesin dhe me lejen e tij e shoqeron te personi i kerkuar.
- Para marrjes se sherbimit, kontrollon objektin ne prezence te rojes dorezuese dhe per crregullimet e konstatuara njofton pergjegjesin e rojeve dhe ate te objektit, duke bere shenimet perkatese ne librin e sherbimit.
- Te kujdeset per ndricimin e jashtem te objektit duke vene ne dijeni pergjegjesin e tij.
- Ne rast zjarri merr masa per shuarjen e tij dhe menjehere njofton zjarrfikeset, policine dhe titullarin e institucionit.
- Te kerkoje nga shtetasit dhe punonjesit te zbatojne rregullat e brendeshme te objektit.
- Kur ne objekt kryhen vepra penale, roja ben bllokimin e mjedisit dhe te autorit dhe njofton menjehere organet kompetente.
- Roja perdore armen sipas legjislacionit në fuqi;
- Roja i objektit per kryrjen e detyrave te tij bashkepunon me policine e rendit
- Roja per marrjen e detyres sipas grafikut duhet te paraqitet 15 minuta para. Atij i ndalohet largimi nga vendi i kryrjes se sherbimit pa u zevendesuar dhe pa marre miratimin e pergjegjesit.
- Ndalohet futja dhe qendrimi i rojeve ne ambientet e brendeshme te objektit, perjashtuar rastet per zbatimin e rregullores.
- Roja gjate kohes se sherbimit duhet te karakterizohet nga sjellja qytetare ne komunikim me persona.
- Roja gjate kohes se sherbimit i ndalohet te pije pije alkolike, te fleje, te bisedoje me njerez te jashtem.
- Roja duhet te zbatoje vetem urdherat e pergjegjesit te rojeve dhe drejtorit te ndermarrjes
- Ne vendroje duhet te kete keto dokumenta:
  - Rregullorja e brendshem
  - Libri i marrjes ne dorezim te sherbimit
  - Grafiku i sherbimit
  - Inventari i materialeve qe ndodhen ne objekt
  - Mjete ndricimi ne rast mungese te energjise elektrike
  - Numerat telefonik te rajoneve te policise, zjarrefikseve dhe te personave kryesore pergjegjes te objektit.
  - Skemen e njoftimit ne rast sulmi ne objekt

- Listen e automjeteve qe lejohen te hyjen apo te parkohen ne objekt
- Rojes i ndalohen bisedat telefonike private
- Roja per probleme urgjente te sherbimit perdor mjetet e nderlidhjes se objektit
- Ndalohet nderrimi i grafikut te sherbimit pa miratimin e pergjegjesit te rojeve.
- Cdo levizje e personalit apo personave te tjere, shenohet ne librin e sherbimit te rojes.

Shpërndarja:

Vendi i kryerjes së shërbimeve: **Godina e Drejtorise se Shendetit Publik ne Lagjen «Sporti» ,  
Ish Infektivi Gramsh.**

